



KOMUNA E RAHOVECIT
OPSTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY OF RAHOVEC

KONTRATA PUBLIKE KORNIZË
623-26-6414-5-2-1/C733

KUVENDI KOMUNAL - RAHOVECË, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe
SELMANS NETWORK SH.P.K., Lagja Spitalit, Rr. Jakov Xoxa, Kompleksi Blini, Co, pn., PRISHTINË, (në
vazhdim "Kontraktori"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike kornizë për Punët e
riparimit/mirëmbajtjes si në vijim:

Titulli i Kontratës: **Renovimet dhe riparimet e objekteve të QMF-ve dhe AMF-ve**

Me numër identifikues: 623-26-6414-5-2-1

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kësaj kontrate publike kornizë është që të themeloj kushtet, duke përfshirë çmimet për njësi dhe rregullat e implementimit për kryerjen e punëve të riparimit/mirëmbajtjes në vijim: **Renovimet dhe riparimet e objekteve të QMF-ve dhe AMF-ve**

Nr.	Grupi
1	Renovimet dhe riparimet e objekteve të QMF-ve dhe AMF-ve

[Autoriteti kontraktues kryen blerje vetëm në emër të vet]

1.2 Kontrata publike kornizë do të implementohet me "vendosjen e porosive" apo thirrje. P.sh. Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet tjetër Kontraktues i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë artikuj në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë "porosinë" tek Kontraktori, duke specifikuar listën e punëve që duhet të performohen me sasi të tyre përkatëse.

1.3 Sasi të vlerësuara, të përcaktuara në Pjesën C, Lista e Çmimit, janë vetëm sasi indikative. Autoriteti(et) Kontraktues i përmendur në Nenin 1.1 është (janë) i/të detyruar të përdorë/in këtë marrëveshje kornizë sa herë që të prokurojnë punë, të përmendura në 1.1.

1.4 Kontrata hynë në fuqi me datën e nënshkrimit dhe përfundon për një periudhë prej **24 Muajsh**

Neni 2 Koha e përfundimit

2.1 Afati kohor për ekzekutimin e punëve do të jetë...ditë nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues.

2.2 Vendi i ekzekutimit të punëve do të jetë: **Në Objektet e Institucioneve Publike**

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimet njësi të punëve riparuese janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimit e paraqitur nga Kontraktuesi.

Vlera totale indikative e kontratës është: **105,820.00** Euro.

[Njëqind e pesëmijë e tetëqind e njëzetë Euro]

Derivimi i lejuar nga vlera totale indikative është: **plus/minus +/- 30%**

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës publike kornizë.

3.3 Çmimet e njësive do të jenë fikse dhe nuk do të nënshtrohen ndryshimeve për porositë e vendosura nën këtë kontratë publike kornizë.

3.4 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veçanta të Kontratës.

Neni 4 Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kontrata Publike Kornizë;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Kontraktuesit duke përfshirë Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Lista e Çmimeve);
- (f) Urdhër blerja;

4.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.


Neni 5 Komunikimet

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të bëhen me shkrim. Komunikatat duhet të dërgohen me postë, mesazh, telefaks, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

5.3 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqimi, miratimi, certifikata apo vendimi do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shënohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

5.4 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhën: Shqipe¹ në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Kontraktuesin.

Për Autoritetin Kontraktues:		Për Kontraktorin:	
Emri:	Astrit Mullabazi	Emri:	Betim Selmanaj
Pozita:	Zyrtar Përgjegjës i Prokurimit	Pozita:	Pronarë
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	17.09.2026	Data:	17.09.2026
Vula:		Vula:	

¹ Gjuha do të jetë gjuha e përdorur nga ana e tenderuesit në këtë tender.

KUSHTET E PËRGJITHSHME

Neni 1 Përkufizimet

1.1 "Kontratë" do të thotë marrëveshje të lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Kontraktuesit, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkorporuar me referencë në të.

1.2 "Punë" konsiderohen të gjitha ato punë të cilat janë objekt i kontratës dhe të cilat Autoriteti Kontraktues kërkon që të kryhen nga kontraktuesi, qofshin ato ndërtim, restaurim, meremetim apo rrënim ndërtesash, pajisje, struktura inxhinieringu civil, struktura të tjera apo pjesë të tyre.

1.3 "Kontraktuesi" është operatori ekonomik (apo grupi i operatorëve ekonomik), i caktuar në formularin e kontratës, i cili (të cilët) është palë në kontratë dhe është i obliguar të kryejë punët sipas marrëveshjes dhe i cili do të marrë shumën sipas marrëveshjes me kontratë.

1.4 "Menaxheri i Projektit" është njeriu i caktuar në kushtet e veçanta të kontratës (apo cilido njeri kompetent i autorizuar nga Autoriteti Kontraktues), i cili është përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së punëve dhe për të gjitha hollësitë duhet t'i raportojë Autoritetit Kontraktues.

1.5 "Çmimi Kontratës" do të thotë shuma që i paguhet Kontraktuesit sipas marrëveshjes në formularin e kontratës.

1.6 "Vendi i ndërtimit" do të thotë vendi i caktuar për kryerjen e punëve të kontraktuara.

1.7 "Pajisjet e kontraktuesit" do të thotë e tërë makineria përfshirë edhe atë për bartjen e pajisjeve, dhe mjetet tjera që nevojiten për kryerjen e punëve të kontraktuara që duhet të bëhen sipas kontratës.

1.8 "Skicat" nënkuptojnë vizatimet, llogaritjet, informatat e siguruar dhe të miratuara nga Autoriteti Kontraktues për kryerjen e punëve të kontraktuara.

1.9 "KPK" do të thotë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.10 "KVK" do të thotë Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Kontraktuesi e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Kontraktuesi nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:

a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Kontraktuesit, të shumave që duhet të paguhet ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose

b) në rast të dhënies së të drejtës së Kontraktuesit siguruesve të Kontraktuesit për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Kontraktuesit.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Kontraktuesin nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

Neni 4

Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Kontraktuesi ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit të ofertës. Në rast të ndryshimit të nënkontraktuesve gjatë implementimit të kontratës, Kontraktuesi duhet të njoftoj me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Kontraktuesin për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Kontraktuesi nuk nënkontraktton pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithë nënkontraktuesit e propozuar duhet të përmbushin kërkesat e përshtatshmërisë.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njeh lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të siguroj, ku e konsideron si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Kontraktuesi është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Kontraktuesit, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Menaxherit të Projektit nuk e liron Kontraktuesin nga obligimet e tij sipas kontratës.

4.5 Nëse nënkontraktuesi ka marrë ndonjë obligim të vazhdueshëm që vazhdon për një periudhë që e tejkalon atë të periudhës së garancisë nën kontratë ndaj Kontraktuesit, përkitazi me furnizimet që i jep nënkontraktuesi, Kontraktuesi duhet që, në çfarëdo momenti pas skadimit të periudhës së garancisë, t'i transferojë menjëherë te Autoriteti kontraktues, me kërkesë dhe shpenzime të Autoritetit kontraktues, përfitimet e obligimeve të tilla për kohëzgjatjen e garancisë së skaduar.

Obligimet e Autoritetit Kontraktues

Neni 5

Dhënia e dokumenteve

5.1 Nëse është e nevojshme, brenda 30 ditësh nga nënshkrimi i kontratës, autoriteti kontraktues duhet t'i japë Kontraktuesit, pa pagesë, një kopje të skicave të përgatitura për realizimin e kontratës dhe kopje të specifikimeve dhe dokumenteve tjera të kontratës. Kontraktuesi mund të blejë kopje tjera të këtyre skicave, specifikimeve dhe dokumenteve tjera, në rast se ato janë në dispozicion. Pas lëshimit të certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi duhet t'i kthen autoritetit kontraktues të gjitha skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera të kontratës.

5.2 Përveç nëse është e nevojshme për qëllime të kontratës, skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera që i jep autoriteti kontraktues nuk duhet të përdoren as nuk duhet t'i komunikohen një pale të tretë nga Kontraktuesi pa pajtim paraprak të autoritetit kontraktues.

5.3 Autoriteti kontraktues ka autoritetin për t'i lëshuar Kontraktuesit urdhra administrative që inkorporojnë ato dokumente plotësuese dhe udhëzimet që janë të nevojshme për ekzekutim të mirë të kontratës dhe për kompensim dëmi nga ndonjë defekt të saj.

Neni 6

Qasja në vend punishte

6.1 Autoriteti kontraktues, në kohën e duhur dhe në përputhje me ecurinë e punimeve, do të jap qasje dhe akses Kontraktuesit në vend punishte, në përputhje me programin e zbatimit të detyrave të përcaktuara në këto Kushte të përgjithshme.

6.2 Kontraktuesi, gjatë shfrytëzimit, duhet të mirëmbaje çdo objekt të vendosur në dispozicion të tij në gjendje të mirë, dhe duhet, nëse kërkohet nga Autoriteti Kontraktues, t'i kthejë ato në gjendjen e tyre origjinale pas përfundimit të kontratës.

6.3 Kontraktuesi nuk do të ketë të drejtë të ndonjë pagese për përmirësimet që rezultojnë nga puna e kryer me iniciativën e tij.

Neni 7

Ndihma lidhur me rregulloret vendore

7.1 Kontraktuesi mund të kërkojë ndihmën e Autoritetit kontraktues për marrjen e kopjeve të ligjeve, rregulloreve dhe informatave mbi zakonet, urdhëratë apo ligjet anësore të Republikës së Kosovës të cilat mund të ndikojnë te Kontraktuesi gjatë realizimit të obligimeve të tij me kontratë. Autoriteti kontraktues mund ta japë ndihmën e

kërkuar Kontraktuesit me shpenzime të Kontraktuesit.

7.2 Në bazë të dispozitave të ligjeve dhe rregulloreve mbi punën, Autoriteti Kontraktues do të bëjë të gjitha përpjekjet e nevojshme për të lehtësuar prokurimin nga Kontraktuesi për të gjitha vizat dhe lejet e nevojshme, duke përfshirë lejen e punës dhe lejet e qëndrimit, për personelin, shërbimet e të cilëve Kontraktuesi dhe Autoriteti kontraktues i konsideron të nevojshme, si dhe lejet e qëndrimit për familjet e tyre.

Obligimet e Kontraktuesit

Neni 8 Obligimet e Kontraktuesit

8.1 Kontraktuesi duhet të veprojë sipas urdhrave administrative që i jep autoriteti kontraktues. Nëse Kontraktuesi konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

8.2 Kontraktuesi duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

8.3 Kontraktuesi duhet t'i trajtojë të gjitha dokumentet dhe informatat e marra lidhur me kontratën si private dhe konfidenciale. Përveç në rastet kur kjo është e nevojshme për qëllime të ekzekutimit të kontratës, ai nuk do të publikojë ose shpalosë asnjë detaj të kontratës pa pajtim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

8.4 Nëse Kontraktuesi është grup, përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit kontraktues.

8.5 Kontraktuesi do të siguroj se punët do të fillojnë dhe të përfundojnë brenda afatit të caktuar rënë dakord në programin e bërë sipas Nenit 12.

8.6 Kontraktuesi do të siguroj që të gjitha punët që ai/ajo do të bëjë, si dhe riparimin e defekteve gjatë realizimit të punimeve do të bëhen në kohë dhe në përputhje me standardet, praktikat, metodat dhe procedurat ekzistuese dhe për më tepër me shkallën e aftësisë dhe zellit, e cila do të pritët nga një kontraktues i aftë dhe me përvojë që ka ndërmarr punë të ngjashme.

8.7 Kontraktuesi do të siguroj për cilësinë e punës dhe për cilësinë e materialeve dhe cilësisë profesionale të punonjësve që janë përdorur për realizimin e punëve të kontraktuara.

8.8 Kontraktuesi duhet të siguroj zonën e ndërtimit menjëherë pas fillimit të punës për arsyet e mëposhtme:

- a. në qoftë se për kryerjen e punëve pajisjet e rënda si: ekskavatorë të llojeve të ndryshme, vinça, kamionë të llojeve të ndryshme, skela të larta, etj do të përdoren; dhe
- b. në mënyrë që të mos dëmtojë kalimtarët e rastit, objektet përreth, trafikun etj.

8.9 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për sigurinë e të gjitha aktiviteteve në vend punim.

Neni 9 Personeli

9.1 Kontraktuesi duhet të punësoj personel kyç dhe të përdor pajisje të identifikuara në tender e tij, për të kryer punë ose personel tjetër dhe pajisje të aprovuara nga menaxheri i projektit. Menaxheri i Projektit do të aprovoj çdo zëvendësim të propozuar të personelit kyç dhe pajisjeve vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse, ose karakteristikat janë në thelb të barabarta ose më të mirë se ato të propozuara gjatë tenderit.

Neni 10 Siguria e ekzekutimit

10.1 Kontraktuesi do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mirë të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të

ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Kontraktuesit.

10.2 Sigurimi do të vazhdojë të mbetet i vlefshëm 30 ditë pas lëshimit të Certifikatës së Pranimit të Përkohshëm.

10.3 Siguria e ekzekutimit të kontratës do të jetë në formën e dhënë në pjesën IV të kontratës.

Neni 11 Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit

11.1 Nga data e fillimit e deri sa të lëshohet Certifikata e Korrigjimit të Defekteve, rreziqet e lëndimeve personale, vdekja, dhe humbja ose dëmtimi i pronës (përfshirë, pa kufizim, Punët, Impiantet, Materiale, dhe Pajisjet) janë rreziqet e Kontraktuesit dhe pronës së afërt.

11.2 Kontraktuesi duhet të sigurojë një sigurim nga dita fillimit të punimeve deri në fund të periudhës garantuese të defekteve në shumat e përcaktuara në KVK për ngjarjet e mëposhtme të cilat janë për shkak të rreziqeve të Kontraktuesit:

- (a) humbje ose dëmtim i Punëve, Impianteve dhe Materialeve;
- (b) humbje ose dëmtim i Pajisjeve;
- (c) humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën; dhe
- (d) dëmtim ose vdekje e personelit të tij.

11.3 Kontraktuesi brenda 15 ditëve pas nënshkrimit të kontratës duhet t'i dërgojë Autoritetit Kontraktues policën dhe certifikatën për sigurim që ka për qëllim kompensimin e nevojshëm për të siguruar humbjen apo dëmet e pësuar.

11.4 Në qoftë se kontraktuesi nuk ofron një sigurim të tillë atëherë kontrata do të konsiderohet e anuluar dhe kontraktuesi do të përjashtohet nga pjesëmarrja në aktivitetet e prokurimit për jo më pak se një vit.

11.5 Në qoftë se ekzistojnë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për zgjatjen e afatit të ofrimit të certifikatës mbi sigurim, Autoriteti Kontraktues mund të zgjasë afatin e caktuar për dorëzimin e certifikatës mbi sigurimin ose të eliminojë sigurimin dhe të zbresë çmimin e shpërblimit nga fitimi i kontraktuesit.

Neni 12 Programi

12.1 Brenda kohës së specifikuar në KVK, kontraktuesi do t'i dorëzojë Menaxherit të Projektit një program për miratim. Programi do të përmbajë së paku me së vijon: mënyrën se si Kontraktuesi propozon ekzekutimin e punëve, afatin kohor që kërkohej për dorëzim dhe miratim të vizatimeve, metodat e përgjithshme që do të zbatoheshin, dhe afatin kohor për secilin aktivitet të specifikuar.

12.2 Nëse menaxheri i projektit për më tepër kërkon modifikime në programin e punëve në kuadër të punëve të kontraktuara, kontraktuesi duhet ta rishikojë edhe njëherë programin dhe t'i kthejë prapë Menaxherit të projektit. Kontraktuesi do të azhurnojë Programin në intervale jo më shumë se periudha e përcaktuar në KVK.

12.3 Për çdo pakënaqësi apo mosmarrëveshje në lidhje me modifikimin e programit, kontraktuesi do të sigurojë argument me shkrim Menaxherit të Projektit.

12.4 Paraqitja e programit të tillë, duke përfshirë çdo shtesë nga menaxheri i projektit nuk do të zvogëlojë ose të rrisë detyrimet e kontraktuesit sipas punëve të kontraktuara, si dhe çdo modifikim të përfshirë në programin e punimeve nuk do të rezultojë në ndonjë pagesë shtesë për kontraktuesin, nëse kjo ka ndodhur si pasojë e neglizhencës së kontraktuesit gjatë përpilimit të programit.

Neni 13 Siguria në vend punishte

13.1 Kontraktuesi do të ketë të drejtën të ndalojë qasjen në vend-punishte për çdo person i cili nuk është i përfshirë në zbatimin e kontratës, me përjashtim të personave të autorizuar nga Autoriteti Kontraktues.

13.2 Kontraktuesi do të sigurojë sigurinë në vend-punishte gjatë gjithë periudhës së ekzekutimit dhe do të jetë përgjegjës për të marrë hapat e nevojshëm, në interes të punonjësve të tij, agjentëve të Autoritetit Kontraktues dhe palëve të treta, për të parandaluar çdo humbje ose aksident i cili mund të rezultojë nga kryerja e punëve.

13.3 Kontraktuesi do të marrë të gjitha hapat e domosdoshme, për përgjegjësinë e tij dhe me shpenzimet e tij, për të siguruar që strukturat dhe instalimet ekzistuese mbrohen, ruhen dhe mirëmbahen. Ai do të jetë përgjegjës për sigurimin, me shpenzimet e tij, ndriçimin, sigurinë, skermën dhe pajisjet e sigurisë të cilat janë të nevojshme për zbatimin e duhur të detyrave ose që me arsye mund të kërkojnë nga Autoriteti Kontraktues

Neni 14 Ndërhyrja me trafikun

14.1 Kontraktuesi do të sigurojë që punimet dhe instalimet nuk shkaktojnë dëme, ose pengojnë trafikun në, lidhjet e komunikimit të tilla si rrugët, hekurudhat, rruge ujore dhe aeroporte. Ai, në veçanti, do të marrë parasysh kufizimet në peshë kur zgjedh rrugët dhe automjetet.

14.2 Çdo masë të veçantë të cilën Kontraktuesi e konsideron të nevojshme, ose është kërkuar nga Autoriteti Kontraktues me qëllim të mbrojtjes apo për të përforcuar pjesët e rrugëve, urave, do të bartet në shpenzime të Kontraktuesit, pa marrë parasysh se ato kryhen nuk ato kryhen nga Kontraktuesi. Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin kontraktues për çfarëdo masa të veçanta që ai synon të ndërmarrë para se kryej ato. Riparimet e dëmit të shkaktuara në rrugë, ura nga transporti i materialeve apo pajisjeve do të jetë në shpenzime të Kontraktuesit.

Neni 15 Tatimi

15.1 Kontraktuesi është përgjegjës për të gjitha tatimet dhe detyrimet doganore në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

15.2 Të gjitha tatimet dhe detyrimet tjera doganore konsiderohet se janë përfshirë në çmimin e kontraktuar.

15.3 Menaxheri i Projektit do të harmonizojë çmimin e kontraktuar nëse konstaton se ka ngritje të tatimeve dhe detyrimeve doganore brenda datës prej 28 ditësh para dorëzimit të tenderit dhe datës së fundit të vërtetimit të përfundimit të punëve.

15.4 Menaxheri i Projektit nuk do të lejojë ndryshimin e çmimit të kontraktuar për shkak të ngritjes së tatimeve dhe/ose ngritjes së detyrimeve doganore në qoftë se kjo ka ndodhur gjatë kohës sa ka qenë në vonesë kontraktuesi.

Neni 16 Kostoja e Riparimeve

16.1 Humbja ose dëmtimi i Punëve ose Materialeve që do të përfshihen në Punët në mes të Datës së fillimit dhe në fund të periudhës së Korrigjimit të Defekteve do të rregullohet nga Kontraktuesi në koston e Kontraktuesit nëse humbja ose dëmtimi lind nga aktet ose mosveprimet e Kontraktuesit.

FILLIMI DHE VONESAT

Neni 17 Fillimi i punëve

17.1 Kontraktori duhet të fillojë punimet sa më shpejt që është e arsyeshme e mundur pas marrjes së urdhrat me ekspeditën e duhur dhe pa vonesë.

17.2 Kontraktuesi do të ekzekutojë Punët në pajtim me Specifikimet dhe Vizatimet dhe Punët do të kryhen në pajtim me Programin e dorëzuar nga Kontraktuesi, i përditësuar me miratimin e Menaxherit të Projektit, dhe do të plotësojë ato brenda afatit kohor të specifikuar në Nenin 2 të Formularit të Kontratës.

Neni 18 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit

18.1 Kontraktuesi mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritë se do të vonohet, për ndonjërin nga këto arsye:

- a) Autoriteti kontraktues ka dështuar t'i plotësojë obligimet e veta sipas kontratës;
- b) Forca madhore të përkufizuara si në Nenin 38;

18.2 Brenda 15 ditësh pasi ka kuptuar se mund të ketë vonesë, Kontraktuesi duhet ta lajmërojë Autoritetin

Kontraktues se ka për qëllim të bëjë kërkesë për zgjatje të periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përveç nëse ka ndonjë marrëveshje tjetër ndërmjet Kontraktuesit dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditësh i jep Autoritetit Kontraktues të dhëna gjithëpërfshirëse ashtu që të mund të kontrollohet kërkesa.

18.3 Brenda 30 ditësh pas pranimit të detajeve sipas Nenit 18.2 Autoriteti Kontraktues do të lejojë me shkrim Kontraktuesit këtë zgjatje të periudhës së realizimit nëse mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive ose retrospektive, ose ta informojë Kontraktuesin që nuk i është dhënë e drejta për zgjatje të periudhës.

Neni 19 Dëmet e likuiduara

19.1 Nëse Furnizues me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha punët brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së punëve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të porosisë. Autoriteti Kontraktues mund të zbresë dëmet e likuiduara nga pagesat të cilat duhet ti behen Kontraktuesit. Pagesat e dëmeve të likuiduara nuk do të prekin detyrimet e kontraktuesit.

19.2 Nëse mosdorëzimi i punëve parandalon përdorimin e zakonshëm të punëve në tërësi, dëmet e likuiduara të parapara në paragrafin 19.1 do të llogariten në bazë të vlerës totale të porosisë.

14.3 Nëse Autoriteti kontraktues ka fituar të drejtën të kërkojë së paku 10 % të vlerës së porosisë ai mundet, pasi ta njoftojë me shkrim Kontraktuesin:

a. Në rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetëm në emër të vetë Autoritetit, me një operatore ekonomik:

- të konfiskojë garancinë e realizimit;
- të ndërpresë kontratën, dhe në këtë rast Kontraktuesi nuk do të ketë të drejtë për kompensim; dhe
- të hyjë në një kontratë me një palë të tretë për dhënien e pjesës së mbetur të punëve. Kontraktuesi nuk do të paguhet për këtë pjesë të kontratës. Kontraktuesi gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij.

b. Në rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetëm në emër të vetë Autoritetit, me disa operatore ekonomik:

- të konfiskojë garancinë e realizimit;
- të ndërpresë porosinë, dhe në këtë rast Kontraktuesi nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Kontraktuesi gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- të ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

c. Në rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar në emër të disa Autoriteteve tjera Kontraktuese, me një operatore ekonomik:

- Autoriteti Kontraktues i cili ka bërë porposinë anulon porosinë dhe ritenderon, dhe në këtë rast Kontraktuesi nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Kontraktuesi i gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- të njoftojë Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues i përmendur që të konfiskojë një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% të porosisë së leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues.

a. Në rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar në emër të disa Autoriteteve tjera Kontraktuese, me disa operatore ekonomik:

- të njoftojë Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues i përmendur që të konfiskojë një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% të porosisë së leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues;
- të ndërpresë porosinë, dhe në këtë rast Kontraktuesi nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Kontraktuesi gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- të ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

Materialet dhe mjeshtëritë

Neni 20 Regjistri i punës

20.1 Një regjistër i punës do të, përveç kur parashikohet ndryshe nga KVK, mbahen në vend-punishte nga ana e Kontraktuesit, i cili do të mbaje të paktën informacionin e mëposhtëm:

- a) kushtet e motit, ndërprerjet e punës që detyrohen nga moti me shi, orët e punës, numrin dhe llojin e punëtorëve të punësuar në vend-punishte, materialet e furnizuara, pajisjet në përdorim, pajisjet jo në gjendje pune, testet e kryera në vend, mostrat e dërguara, rrethanat e paparashikuara si dhe urdhrat dhënë Kontraktuesit;
- b) deklaratat e hollësishme të të gjitha elementeve sasiore dhe cilësore të punës së bërë dhe furnizimet e dorëzuara dhe të përdorura, të afta për tu kontrolluar në vend-punishte dhe të rëndësishme në llogaritjen e pagesave që duhet bërë Kontraktuesit.

20.2 Shënimet e bëra në regjistrin e punës, si pune në progres, duhet të nënshkruhen nga Autoriteti Kontraktues dhe të bashkë-nënshkruhen nga Kontraktuesi ose përfaqësuesi i tij. Nëse Kontraktuesi refuzon, ai do të komunikojë pikëpamjet e tij ndaj Autoritetit Kontraktues në afat prej 15 ditësh pas datës në të cilën janë regjistruar të dhënat apo deklaratat kundërshtuese. Nëse Kontraktuesi dështon që të nënshkruajë ose të paraqesë pikëpamjet e tij brenda periudhës së lejuar, do të konsiderohet se Kontraktuesi pajtohet me shënimet e paraqitura në regjistër. Kontraktuesi mund të shqyrtojë regjistrin e punës në çdo kohë dhe mund, pa hequr dokumentin, të bëjë ose të marrë një kopje të shënimeve të cilat ai i konsideron të nevojshme për informacionin e tij.

20.3 Sipas kërkesës, Kontraktuesi do ta sigurojë Autoritetin Kontraktues me informacionin e duhur për të mbajtur regjistrin e punës në mënyrën e duhur.

Neni 21 Origjina dhe cilësia e punimeve dhe materialeve

21.1 Punët, komponentët dhe materialet do të jenë në përputhje me specifikimet, vizatimet, sondazhet, modelet, mostrat, strukturat dhe kërkesat tjera në kontratë dhe do të mbahen në dispozicion të Autoritetit kontraktues për qëllime identifikimi gjatë gjithë periudhës së realizimit.

21.2 Të gjitha pranimet teknike preliminare do të jenë objekt i një kërkesë të dërguar nga Kontraktuesi tek Autoriteti Kontraktues. Kërkesa duhet të referohet numrit të kontratës, numrin e Lotit dhe vendin ku do të zhvillohet pranimi i tillë, sipas rastit. Komponentët dhe materialet e specifikuar në kërkesë duhet të certifikohen nga autoriteti kontraktues se plotësojnë kërkesat për këtë pranim para se të inkorporohen në pune.

21.3 Edhe nëse janë pranuar teknikisht materialet apo artikujt që do të përfshihen në pune ose në prodhimin e komponentëve, ato mund të refuzohen dhe duhet të zëvendësohen menjëherë nga Kontraktuesi nëse ndonjë kontrollim tjetër zbulon defekte ose gabime. Kontraktuesit mund t'i jepet mundësia t'i riparojë dhe t'i përmirësojë materialet dhe artikujt që janë refuzuar, por këto materiale dhe artikuj do të pranohen për inkorporim në pune vetëm nëse janë riparuar.

Neni 22 Inspektimi dhe testimi

22.1 Autoriteti Kontraktues do të emëroj "*Menaxherin e Projektit*", të cekur në KVK, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e ekzekutimit të punëve gjatë tërë kohës, duke filluar që nga dita e parë e fillimit të punëve e deri në skadimin e periudhës garantuere të defekteve dhe për raportim tek Autoriteti Kontraktues.

22.2 Qëllimi i mbikëqyrjes është të kontrollojë cilësinë e punëve dhe cilësinë e materialeve të përdorura në pajtim me specifikimet teknike të rëna dakord.

22.3 Kontraktuesi do të sigurojë që komponentët dhe materialet të dorëzohen në kohë në vend për të lejuar autoritetit kontraktues që të vazhdojë me pranimin e komponentëve dhe materialeve. Kontraktuesi konsiderohet se ka vlerësuar plotësisht vështirësitë që mund t'i hasë në këtë aspekt, dhe nuk do të lejohet që të paraqesë ndonjë arsye për vonesë në përmbushjen e detyrave.

22.4 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë, ose nga vetë ose agjentit e tij, që të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë progresin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për ofrimin e sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar. Kjo do të bëhet në vendin e prodhimit, fabrikimit, përgatitjes ose në vend-punishte ose në ndonjë vend tjetër, siç mund të specifikohet në kontratë.

22.5 Nëse komponentët dhe materialet i kanë kaluar testet, Autoriteti kontraktues do ta njoftojë Kontraktuesin ose do të miratojë certifikimin e procedurës lidhur me këtë.

22.6 Nëse Autoriteti Kontraktues dhe Kontraktuesi nuk pajtohen për rezultatet e testit, secili do të japë një deklaratë për pikëpamjet e tij ndaj tjetrit brenda 15 ditëve pas ngritjes së mosmarrëveshjes së tillë. Autoriteti kontraktues ose Kontraktuesi mund të kërkojnë që këto teste të përsëriten në të njëjtat kushte dhe rrethana, ose nëse ndonjëra palë kërkon, nga një ekspert që zgjidhet me pëlqimin e përbashkët. Të gjitha raportet e testimit do t'i dorëzohen autoritetit kontraktues i cili do t'i komunikojë rezultatet e këtyre testeve pa vonesë te Kontraktuesi. Rezultatet e ri-testimit do të jenë përfundimtare. Kostoja e ri-testimit do të bartet nga pala pikëpamja e të cilit dëshmohet se është gabim nga ri-testimit.

Neni 23 Paralajmërim i hershëm

23.1 Kontraktuesi pa humbur kohë do të informojë Menaxherin e Projektit, në qoftë se ai/ajo vëren ndonjë gabim apo lëshim në skica (vizatime) apo edhe në specifikime teknike gjatë kryerjes së punëve duke ia tërhequr vërejtjen se ato mund të ndikojnë me vone në kualitetin e punëve.

23.2 Nëse Menaxheri i Projektit vëren ekzistimin e disa gabimeve apo lëshimeve, qofshin ato në skica apo në specifikim teknik, ai/ajo do t'i evitojë menjëherë dhe do t'i konsiderojë pasojat.

23.3 Nëse palët në kontratë vlerësojnë se ndërrimet substanciale të punëve janë bere te nevojshme për shkak të gabimeve të tilla ose të përjashtimeve të cilat substancialisht ndikojnë në çmimin e kontratës, atëherë Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me autoritetin kontraktues do të korrigjojë dhe kompensojë situatën sipas Ligjit të Prokurimit Publik.

PAGESAT

Neni 24 Parimet e përgjithshme të pagesave

24.1 Pagesat do të bëhen në Euro.

24.2 Pagesat do të rregullohen për zbritje për pagesat paradhënie dhe të mbajtjes. Autoriteti Kontraktues duhet të paguaj Kontraktuesit shumën e certifikuar nga Menaxheri i Projektit brenda 30 ditëve nga data e çdo certifikate. Nëse Autoriteti Kontraktues bën një pagesë me vonesë, Kontraktuesit do t'i paguhet interes për pagesë me vonesë në pagesën e ardhshme. Interesi do të llogaritet nga data në të cilën pagesa duhet të ishte bërë, deri në datën kur pagesa është bërë me vonesë, e rregulluar sipas bankave vendase për kredi në sektorin e ndërtimit.

24.3 Artikujt e Punëve për të cilat nuk është dhënë normë apo çmim nuk do të paguhet nga Autoriteti Kontraktues dhe do të konsiderohen të mbuluara nga normat dhe çmimet tjera në Kontratë.

24.4 Pagesat që duhet të bëhen sipas faturës së lëshuar nga Kontraktuesi do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, **Identifikimi Financiar**, i kësaj kontrate që e plotëson Kontraktuesi. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

24.5 Në rast se Autoriteti kontraktues kryen blerje në emër të autoriteteve të tjera kontraktuese, dhe një autoriteti kontraktues nuk i përmbush detyrimet e tij sipas kësaj kontrate, veçanërisht obligimet e Nenit 24.2 kontraktori mund të informojë AQP-ne për shkelje të tilla. AQP-ja mund të ndalojë autoritetin kontraktues nga përdorimi i çdo dhe të gjitha kontratat qendrore publike kornizë të nxjerra nga AQP.

Neni 25 Paramasa dhe Parallogaria

25.1 Paramasa dhe parallogaria duhet të përmbajnë pajisje për ndërtim, instalim, testim, dhe punën e komisioneve që duhet të kryhet nga ana e Kontraktuesit. Paramasa dhe parallogaria përdoret për të llogaritur çmimin e kontratës. Kontraktuesi do të paguhet për sasinë e punës së kryer në normën e Paramasës dhe Parallogarisë për çdo artikull.

25.2 Në rast të kontratës paushallë, Përshkrimi i Aktivitetit duhet të përmbajë aktivitetet me çmim për punët e kryera nga ana e Kontraktuesit. Përshkrimi i Aktivitetit përdoret për monitorim dhe kontroll të kryerjes së aktiviteteve në bazë të të cilave Kontraktuesi do të paguhet. Nëse pagesa për Materiale në vend punim do të bëhet veç e veç, Kontraktuesi do të tregojë shpërndarjen e Materialeve në vend punim veçmas në Përshkrimin e Aktivitetit.

Neni 26 Parapagimi

26.1 Autoriteti Kontraktues do të bëjë pagesë paradhënie Kontraktuesit të shumave të përcaktuara në KVK nga data e caktuar në KVK kundër dispozitës nga Kontraktuesi i një Garancioni të Pakushtëzuar Bankar në një formë të pranueshme për Autoritetin Kontraktues në sasi dhe valutë të barabartë me parapagim. Garancia do të mbetet në fuqi deri sa të bëhet pagesa e parë, por shuma e garancisë duhet të reduktohet në mënyrë progresive nga shuma që paguhet nga Kontraktuesi. Interesi nuk do të paguhet për parapagim.

26.2 Kontraktuesi do të përdorin parapagimin vetëm për të paguar Pajisjet, materialet dhe shpenzimet e tjera të nevojshme posaçërisht për kryerjen e punëve. Kontraktuesi duhet të dëshmojë se pagesa paradhënie është përdorur në këtë mënyrë me furnizim të kopjeve të faturave ose dokumenteve të tjera për Menaxherin e Projektit.

26.3 Parapagim do të paguhet duke zbritur shuma proporcionale nga pagesat përndryshe për shkak të Kontraktuesit, pas orarit të përqindjeve të përfunduar të Punëve në bazë të pagesës.

Neni 27 Mbajtja e Parasë

27.1 Shuma, e specifikuar në KVK, do të ndalet nga çdo pagesë e Kontraktuesit deri në përfundim të tërë të Punëve. Kjo shume në asnjë rast nuk do të tejkalojë 10% e vlerës totale të kontratës origjinale. Kontraktuesi mund të zëvendësojë paratë e mbajtura me garancion bankar “me kërkesë”.

27.2 Shuma e mbajtur ose garancia e mbajtjes do të paguhet brenda 30 ditësh nga dita e lëshimit të deklaratës së llogarisë përfundimtare të referuar në Nenin 29.

Neni 28 Vërtetimet e pagesës

28.1 Kontraktuesi do t'i dorëzojë Menaxherit të projektit raportet mujore të çmimeve të vlerësuara të punëve të përfunduara me minus shumën kumulative të vërtetuar më parë.

28.2 Menaxheri i Projektit do ta kontrollojë punën e kryer të kontraktuesit për të vërtetuar cilësinë e punës dhe vërteton shumën që duhet t'i paguhet kontraktuesit.

28.3 Vlera e punës së kryer do të përcaktohet nga Menaxheri i Projektit.

28.4 Vlera e punës së përfunduar përfshin:

- a. Në rastin e Kontratës së Paramasës dhe Parallogarisë, vlerën e sasisë së punës në Paramasë dhe Parallogari që është përfunduar; ose
- b. Në rast të kontratës paushallë, vlera e punës së ekzekutuar do të përbëjë vlerën e aktiviteteve të përfunduara në Përshkrimin e Aktivitetit.

28.5 Vlera e punës së përfunduar përfshin vlerësimin e ndryshimeve dhe shkaqeve për kompensim.

Neni 29 Llogaritja përfundimtare

29.1 Kontraktuesi jo më vonë se 90 ditë pas lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit, do të dorëzojë tek Menaxheri i Projektit një draft të deklaratës së llogarisë përfundimtare me dokumentet mbështetëse që tregojnë në

detaje vlerën e punës së bërë në përputhje me kontratën, së bashku me të gjitha shumat e mëtejshme të cilën Kontraktuesi konsideron se duhet paguar sipas kontratës, në mënyrë që Menaxheri i Projektit të përgatisë deklaratën e llogarisë përfundimtare.

29.2 Brenda 30 ditëve pas pranimit të draft-deklaratës së llogarisë përfundimtare dhe të gjithë informacionit të kërkuar në mënyrë të arsyeshme për verifikimin e saj, Menaxheri i Projektit do të përgatisë deklaratën e llogarisë përfundimtare, e cila përcakton:

- a) Shumen e cila sipas opinionit të tij duhet të paguhet sipas kontratës; dhe
- b) pas evidentimit të shumave të paguara paraprakisht nga Autoriteti Kontraktues dhe i të gjitha shumave të cilat i takojnë Autoritetit Kontraktues sipas kontratës, bilanci, nëse ka, nga Autoriteti Kontraktues tek Kontraktuesi, ose nga Kontraktuesi tek Autoriteti Kontraktues, siç mund të jetë rasti.

29.3 Menaxheri i Projektit do të lëshojë te autoriteti kontraktues ose te përfaqësuesi i tij i autorizuar, dhe te Kontraktuesi, deklaratën e llogarisë përfundimtare që paraqet shumen përfundimtare për të cilën duhet paguar Kontraktuesi në bazë të kontratës. Autoriteti kontraktues ose përfaqësuesi i tij i autorizuar dhe Kontraktuesi duhet të nënshkruajnë deklaratën e llogarisë përfundimtare, si një njohje e vlerës së plotë dhe përfundimtar të punës së realizuar sipas kontratës dhe menjëherë do të dorëzojë një kopje të nënshkruar të Menaxherin e Projektit.

Neni 30 Shkaqet për kompensim

30.1 Shkaqe për kompensim konsiderohen ngjarjet si në vijim:

- (a) Autoriteti Kontraktues nuk lejon qasje në një pjesë të vend ndërtimit data e posedimit e specifikuar në KVK.
- (b) Menaxheri i Projektit urdhëron shtyrje pa dhënë llogari për këtë, ose vonohet apo nuk i jep skicat (vizatimet, specifikacionet) apo udhëzimet e duhura për kryerjen e punëve të kontraktuara në afatin e caktuar si në kontratë.
- (c) Menaxheri i Projektit urdhëron kontraktuesin që t'i zbulojë ose kryejë testet në punën përfundimtare, e cila mandej zbulohet se nuk ka pasur defekt.
- (d) Kontraktuesit tjerë, autoritetet publike, shërbimet komunale ose Autoriteti Kontraktues shkaktojnë vonesë apo shpenzime shtesë për Kontraktuesin.
- (e) Menaxheri i Projektit pa arsye të justifikuar vonohet në lëshimin e vërtetimit për përmbushje të kontratës.
- (g) Kontraktuesi has në pengesa tjera për kryerjen e aktiviteteve të punëve të kontraktuara të cilat pengesa nuk janë për shkak të joprofesionalizmit të Kontraktuesit.

30.2 Nëse një ngjarje e tillë ndodh, atëherë Çmimi i Kontratës do të rregullohet po ashtu.

PRANIMI DHE PËRGJEGJËSIA MBI DEFECTET

Neni 31 Parimet e përgjithshme

31.1 Verifikimi i punëve nga Autoriteti Kontraktues me qëllim të pranimit të përkohshëm ose final do të bëhet në prani të Kontraktuesit. Mungesa e kontraktuesit nuk do të jetë pengesë për verifikimin me kusht që Kontraktuesi të jete informuar prej të paktën 30 ditëve para datës së verifikimit.

Neni 32 Testet për përfundimin

32.1 Punët nuk do të pranohen deri sa të jene kryer verifikimet dhe testet e caktuara në shpenzime të Kontraktuesit. Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktues për datën në të cilën verifikimi dhe testet të tilla mund të fillojnë.

32.2 Punët të cilat nuk plotësojnë kushtet e kontratës, duhet, nëse kërkohet, të shkatërrohen dhe rindërtohen nga kontraktuesi ose të riparohen, sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues, përndryshe kjo do të bëhet pas njoftimit të duhur në shpenzime të Kontraktuesit, me urdhër të Autoritetit Kontraktues.

Neni 33 Pranimi i përkohshëm

33.1 Punimet do të merren përsipër nga Autoriteti kontraktues kur të kenë kaluar në mënyrë të kënaqshme testet për pranim dhe të jete lëshuar, ose konsiderohet të jete lëshuar, **një certifikatë e pranimi të përkohshëm**.

33.2 Kontraktuesi mund të aplikojë, duke njoftuar Autoritetin Kontraktues, për një certifikatë të pranimi të përkohshëm jo më herët se 15 ditë para se punët, sipas mendimit të Kontraktuesit, të jene të gatshme për pranim të përkohshëm. Autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh pas pranimi të aplikacionit të Kontraktuesit ose:

- a) t'i lëshojë kontraktuesit certifikatën e pranimi të përkohshëm me një kopje për Autoritetin kontraktues duke thënë, nëse kjo është e përshtatshme, rezervat e tij, dhe përveç tjerash, edhe datën në të cilën sipas mendimit të tij janë përfunduar punët në pajtim me kontratën dhe janë të gatshme për pranim të përkohshëm; ose
- b) të refuzojë aplikacionin, duke i dhënë arsyet e tij dhe duke specifikuar veprimin të cilin, sipas mendimit të tij i kërkon nga Kontraktuesi për ta lëshuar certifikatën.

33.3 Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin ose të lëshojë certifikatën e pranimi të përkohshëm ose të refuzojë furnizimet brenda një periudhe prej 30 ditësh, ai do të konsiderohet se ka lëshuar certifikatën në ditën e fundit të asaj periudhe.

33.4 Pas pranimi të përkohshëm të punëve, Kontraktuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkohen më për përdorim përkitazi me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe do të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimi siç kërkohen në kontratë.

Neni 34 Përgjegjësia mbi Defektet

34.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve, në ndonjë pjesë të punëve të cilat mund të shfaqen apo shfaqen gjatë periudhës së defekteve dhe të cilat lindin nga ose:

- a) përdorimin i impiantit ose materialeve të dëmtuara ose mjeshtëria ose dizajni i gabueshme i Kontraktuesit; dhe / ose
- b) çdo veprim apo mosveprim i Kontraktuesit gjatë periudhës së defekteve.

34.2 Kontraktuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt të jetë e mundur. Periudha mbi përgjegjësinë e defekteve për të gjitha zëvendësimet ose rinovimet do të fillojë nga data kur zëvendësimi ose rinovimi është bërë për kënaqësinë e mbikëqyrësit. Nëse kontrata mundëson pranim të pjesshëm, periudha e defekteve do të vazhdojë vetëm për atë pjesë të punimeve e cila është ndikuar nga ndërrimi apo rinovim.

34.3 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së përmendur, autoriteti kontraktues ose menaxheri i projektit do ta njoftojë Kontraktuesin. Nëse Kontraktuesi nuk arrin të korrigjojë një defekt ose një dëm brenda afatit kohor të përcaktuar në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të kryejë vetë punë, ose të punësojë dikë tjetër për kryerjen e punimeve, në rrezik dhe kosto të Kontraktuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga pagesat e pritura ose nga garancitë që mbahen ndaj Kontraktuesit ose nga të dy; ose
- b) të ndërpresë kontratën.

34.4 Në raste urgjente, kur kontraktuesi nuk mund të arrihet menjëherë ose, pasi është arritur, nuk është në gjendje që të marrë masat e nevojshme, autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit mund të kryejë punën në kurriz të Kontraktuesit. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit duhet të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur Kontraktuesin për veprimin e marrë.

34.5 Periudha e përgjegjësisë së defekteve do të parashihet në KVK dhe specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së përgjegjësisë së defekteve nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e Përgjegjësisë së defekteve do të fillojë në datën e pranimit të përkohshëm.

Neni 35 Pranimit përfundimtar

35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Kontraktuesit një **certifikatë të pranimit përfundimtar**, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimit do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 34 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimit nga Menaxheri i Projektet dhe të jete dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit dhe të cilat kanë mbetur të përealizuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimit. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

Shkelja e kontratës dhe shkëputja

Neni 36 Shkelja e kontratës

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhet Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria

Neni 37 Shkëputja e kontratës

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijnë, por nuk do të kufizohet në:

- (a) Kontraktuesi ndërprente punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- (b) Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonës;
- (c) Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
- (d) Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- (e) Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;

(f) Kontraktuesi vonohet në përmbushjen e Punëve për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur cilado nga palët kontraktuese njofton Menaxherin e Projektit për shkelje të kontratës për arsye të tjera nga ato të renditura më lart nën 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë a është shkelja thelbësore apo jo.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesit do të përfundojë vazhdimësinë e përmbushjes së punëve sa më parë që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të sigurojë vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

Neni 38 Forca madhore

38.1 “**Force Madhore**” siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplodimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkaktuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësisë të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t’i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t’i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t’i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

Neni 39 Pagesa pas shkëputjes së kontratës

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të lëshojë një çertifikatë mbi vlerën e punës së përfunduar dhe materialet e porositura me më pak se përqindja e cila kërkohej nga vlera e punëve të përfunduara, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshojë një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve.

Neni 40

Prona

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 41

Lirimi nga Ekzekutimi

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri I Projektit do të vërtetojë këtë. Kontraktuesi do të sigurojë vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Neni 42 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 43

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo që palët pajtohen, vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

30.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

KUSHTET E VEÇANTA
623-26-6414-5-2-1/C733

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë: Gjuha Shqipe.
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit është: 10 % të vlerës së kontratës , për kohëzgjatjen e periudhës prej: 25 Muaj nga data e nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Nëse ndodh ndonjë humbje ose dëmtim lidhur me punët, ndonjë pjesë e tyre, Impianteve dhe Materialeve gjatë periudhës mbi të cilën kontraktuesi është përgjegjës për përkujdesjen e tyre, për çfarëdo arsye, përpos rreziqeve të definuar sipas nenit 38 të KPK, kontraktuesi korrigjon humbjen apo dëmtimin e tillë nën shpenzimet e veta, në mënyrë që punët e përhershme në çdo aspekt të jenë në përputhje me dispozitat e kontratës sipas kërkesave të menaxherit të kontratës. Kontraktuesi siguron punët, së bashku me materialin dhe impiantin gjer në koston e zëvendësimit të plotë; (b) Nëse ndodh ndonjë humbje ose dëmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre; (c) Nëse ndodh ndonjë humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është: 15.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar; (d) Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje: (i) të punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar, (ii) të personave të tjerë: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar,
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzoj për aprovim Programin për Punët brenda: 15 ditë kalendarike nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periudha për Programin e azhurnuar është: 15 ditë kalendarike nga data e pranimit të kërkesës së Menaxherit të Projektit.
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë nga dita e caktuar në Planin e Menaxhimit nga Menaxheri i Projektit.
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë: Sipas Dinamikës së punëve dhe arsyeshmeris së vonesave të lejuara nga organi mbikëqyrës.
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë: 0.25 % e Çmimit përfundimtar të Kontratës për ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është: 10 % e Çmimit final të Kontratës
Regjistri i punës	20.1	Një regjistër i punës do të mbahen në Vend – Punishte nga ana e Kontraktuesit.

Inspektimi dhe testimi	22.1	Inspektimi dhe testimi behet konform kushteve te pergjithshme te kontrates. Menaxheri i Projektit do te percaktohet pas nenshkrimit te kontrates me vendim nga Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA)
Pagesat	24.1	Pagesat do te behen ne Euro. Autoriteti Kontraktues do ti paguaj kontraktuesit vleren e kontraktuar ne situacion.
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit nuk aplikohet.
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave te mbajtura nuk aplikohet.
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë: 15 ditë kalendarike pas nënshkrimit të kontratës
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periudha garantuese e defekteve është: 24 Muaj . Periudha e përgjegjësisë se defekteve do të fillojë në datën e pranimit të punëve.
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është: përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve të likuiduara
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Zyra e Prokurimit – Komuna e Rahovecit
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet [Gjykata Themelore Prishtinë] në pajtim me ligjin në Kosovë.

DEKLARATË MBI SPECIFIKIMET TEKNIKE

Operatori Ekonomik: SELMANS NETWORK SH.P.K.

Drejtori: Betim Selmanaj

Adresa: Rruga Xixa Jakova p.n., Kompleksi Blini Co, Prishtinë

Nr. i prokurimit: 623-26-6414-5-2-1

Nr. i brendshëm: 623-26-029-5-2-1

Titulli i aktivitetit të prokurimit:

"Renovimet dhe riparimet e objekteve të QMF-ve dhe AMF-ve"

DEKLARATË

Ne, **SELMANS NETWORK SH.P.K.**, me seli në Rrugën Xixa Jakova p.n., Kompleksi Blini Co, Prishtinë, të përfaqësuar nga Drejtori **Betim Selmanaj**, deklarojmë se për aktivitetin e prokurimit me:

- **Nr. të prokurimit:** 623-26-6414-5-2-1
- **Nr. të brendshëm:** 623-26-029-5-2-1
- **Titulli:** "Renovimet dhe riparimet e objekteve të QMF-ve dhe AMF-ve"

do të ofrojmë dhe realizojmë të gjitha punët, materialet, pajisjet dhe shërbimet në përputhje të plotë me **specifikimet teknike, paramasën, kërkesat e Autoritetit Kontraktues, projektin dhe dokumentacionin e tenderit.**

Deklarojmë se të gjithë materialet dhe produktet që do të përdoren gjatë realizimit të kontratës do të jenë **të reja, të përshtatshme për destinimin e tyre, cilësore dhe në përputhje me standardet teknike të kërkuara.**

Gjithashtu, SELMANS NETWORK SH.P.K. merr përsipër që:

1. Të respektojë të gjitha specifikimet dhe kërkesat teknike të përcaktuara në dosjen e tenderit.
2. Të përdorë materiale dhe produkte që përmbushin standardet dhe cilësinë e kërkuar.
3. Të realizojë punimet sipas rregullave të profesionit dhe kërkesave teknike.
4. Të sigurojë që materialet e propozuara të jenë në përputhje me specifikimet teknike të Autoritetit Kontraktues.
5. Të zëvendësojë çdo material ose produkt që nuk përputhet me kërkesat teknike të përcaktuara.
6. Të respektojë afatet dhe kushtet e përcaktuara me kontratë.
7. Të jetë përgjegjës për cilësinë dhe përputhshmërinë e punimeve dhe materialeve të përdorura gjatë realizimit të projektit.

Me këtë deklaratë konfirmojmë se **SELMANS NETWORK SH.P.K.** i pranon dhe i përmbush kërkesat e specifikimeve teknike të aktivitetit të prokurimit dhe angazhohet për realizimin e punimeve në përputhje me dokumentacionin e tenderit dhe kërkesat e Autoritetit Kontraktues.

Prishtinë, 24.08.2026

SELMANS NETWORK SH.P.K.

Drejtori: Betim Selmanaj

Nënshkrimi dhe vula



**PARAMASA DHE PARALLOGARIA PËR RENOVIMIN E OBJEKTEVE
SHËNDETËSORE NË KOMUNËN E RAHOVECIT**

I					
MEREMETIMI I AMF-SË NË XËRXË					
I PUNET E RENOVIMIT DHE MEREMETIMIT					
Nr.	Përshkrimi i Posicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma
1	Gerryerja me kujdes dhe largimi i gjetit të dentuar në muret e kthinave të ambulantes, ngarkimi dhe transporti i materialit në deponi.	m ²	165	2	330.00 €
2	Furnizimi, transporti dhe gjetimi i mureve në hapësirat e koridoreve dhe ordinancave të objektit të Ambulantes.	m ²	165	2	330.00 €
3	Furnizimi, transporti dhe ljerja e mureve me polikollor dhe ate në dy shtresa.	m ²	880	1	880.00 €
4	Rregullimi i nyjes sanitare në banjën e objektit të ambulantes, eliminimi i gypit të dëmtuar furnizues, dhe shkarkues shpërndarës, rregullimi dhe funksionalizimi i tij. Në çmim të llogaritë demontimi dhe furnizimi me montim i keramikave dhe demolimi dhe fasadimi i izolimit të fasadës së jashtme të objektit.	komplet	1	250	250.00 €
5	Riparimi i derës ekzistuese prej Profileve të PVC-se, si dhe vendosja e brushave në pjesën e poshtme të derës dykraheshe për mos depertimin e të ftoftit. Dera është me gjerësi b=260cm.	copë	2	80	160.00 €

6	Prerja dhe demolimi me kujdes I murit ndarës I muratuar me blloka giter për krijimin e hapjes te kartoteka.Në çmim të llogaritët ngarkimi dhe transporti I materialit në deponi.Llogaria për m ² të murit	m ²	12	25	300.00 €
7	Furnizimi, transporti dhe suvatimi I murit me llaq të vazhduar dhe ate në dy shtresa.	m ²	20	7	140.00 €
8	Furnizimi, transporti dhe gletimi I nurit me glet masë, sipa rregulloreve, në çmim të llogaritët edhe lyerja.	m ²	20	11	220.00 €
9	Prerja dhe demolimi me kujdes I murit ndarës I muratuar me blloka giter për krijimin e hapjes te intervenimi.Në çmim të llogaritët ngarkimi dhe transporti I materialit në deponi.Llogaria për m ² të murit	m ²	15	25	375.00 €
10	Furnizimi, transporti dhe muratimi I murit ndarës me blloka Gjysëm giter me llaq prej qimentoje me trashësi të murit b=25cm. Në çmim të llogaritët edhe punimi traht shtaungues prej betoi me prerje tërthore 25x25cm dhe I armuar me armature 4Ø10mm dhe stafa Ø8mm/20cm.	m ²	15	20	300.00 €
11	Furnizimi, transporti dhe suvatimi I nurit me llaq të vazhduar dhe ate në dy shtresa.	m ²	30	7	210.00 €
12	Furnizimi, transporti dhe gletimi I nurit me glet masë, sipa rregulloreve, në çmim të llogaritët edhe lyerja.	m ²	30	11	330.00 €

13	Furnizimi, transporti me ngjites dhe keramika si dhe montimi I keramikave ne dysHEME ne pjesen ku eshte bere demolimi I murit, kermaikat jene identike me ato ekzistuese. Ne çmim te llogaritet edhe fugimi I tyre.	m ²	1.5	35	52.50 €
14	Furnizimi, transporti dhe montimi I kalldajes te prodhuesit ENRAD apo prodhues tjeter me karakteristikat identike me pelet me kapacitet 35kë, se bashku me te gjitha pjeset percljellse dhe montuese, si dhe testimi I saj pas montimit.	copë	1	2500	2,500.00 €
15	Furnizimi, transporti dhe montimi I Radiatorit per nxemje qendrore 60x120cm, te prodhuesit Enrad apo prodhues tjeter me karakteristika te njejta.	copë	1	80	80.00 €
16	Demolimi me kujdes I mureve ekzistuese te atikes se kulmit me lartesi H=120 deri 140cm, ngarkimi dhe transporti ne deponi .	m'	130	15	1,950.00 €
17	Demontimi me kujdes I kulmit dhe konstruksionit te objektit te ambullantes , ngarkimi dhe transporti ne deponi.	m ²	285	10	2,850.00 €
18	furnizimi, transporti dhe punimi I konstruksionit drunor te kulmit duke perfshire trajet, shtyllat, shtangimet,brinjet, brinaket. Kulmi te punohet prej drurit halor te kat. Se dyte me perqindje te lageshtise jo me te madhe se 18%.Materialit te jene sipas rregulloreve per keto pozixcione.	m ²	320	18	5,760.00 €

19	Furnizimi, transporti dhe montimi I llamaraines se valezuar me trashesi t=0.4mm ne kulmin e obbjektit, ne çmim te llogaritet e punimi I kulmareve sipas rregullores.	m ²	320	15	4,800.00 €
20	Furnizimi, transporti dhe montimi I olluqeve horizontale dhe vertikale prej llamarine te plastifikuar me trashesi t=0.4mm.	m'	94	10	940.00 €
21	Furnizimi, transporti, montimi I ngjitesit, rrjetes dhe fasadimi I I jashtem I obbjektit te Ambullantes, ne çmim te llogaritet furnizimi, transport, montimi dhe demontimi I skelerise. Nuanac e fasades sipas perzgjegjes se investitorit.	m ²	350	28	9,800.00 €
22	Demontimi me kujdes I deres dykraheshe prej PVC-je dhe vendosja ne vendin e caktuar nga autoriteti kontraktues. Dimensionet e deres 240x260cm.	copë	1	250	250.00 €
23	Demontimi me kujdes I tokut dhe deres ekzistuese te ordinances, ne çmim te llogaritet montimi I serishe I saj ne hapsiren e re te krijuar.	copë	1	200	200.00 €
24	Prerja dhe demolimi me kujdes I murit ndarës I muratuar me blloka giter për hapjen e derës për ordinancë. Në çmim të llogaritet ngarkimi dhe transporti I materialit në deponi. Llogaria për m ² të murit të thyer.	m ²	2.5	30	75.00 €

25	Furnizimi, transporti dhe muratimi I murit ndarës me blloka Gjysëm giter me llaq prej qimentoje me trashësi të murit b=25cm.Në çmim të llogaritët edhe punimi traut shtaungues prej betoi me prerje tërthore 25x25cm dhe I armuar me armature 4Ø10mm dhe stafa Ø8mm/20cm.	m²	20	30	600.00 €
26	Furnizimi transporti dhe montimi I dritares me dimesnione 180x140cm, prej profileve te PVC-se me trashesi t=86mm dhe xham te trefisht termopan, 4mm, dritarja te jete me dy hapje vertikale dhe me kiper.Profili te jete, Veka, Komerling, Rehau apo prodhues te jete me karakteristika te njejta.	copë	1	550	550.00 €
27	Furnizimi, transporti dhe monrimi I sollbankave(pikoreve) prej graniti me trashesi t=2cm ne ane e jashtme dhe te mbrendshme te dritares.	m²	0.8	350	280.00 €
28	Furnizimi, transporti dhe suvatimi I nurit me llaq të vazhduar dhe ate në dy shtresa.	m²	40	7	280.00 €
29	Furnizimi, transporti dhe gjetimi I nurit me glet masë, sipa rregulloreve, në çmim të llogaritët edhe lyerja.	m²	40	11	440.00 €
30	Furnizimi transporti dhe montimi I derës prej furniri dhe tok prej hekuri, modeli dhe nuanca si ato ekzistuese, me dmimensione 110x200cm, ndërsa toku të jetë me gjerësi	copë	1	350	350.00 €
31	Furnizimi, transporti montimi I pllakave të armstrongut së bashku me konstruksion mbajtës, pllakat të jenë idëntike me ato ekzistuese.	m²	15	35	525.00 €

32	Furnizimi, transporti dhe montimi i llampave ndriçuese LED të pllafonit me kapacitet 40ë, së bashku me kabëll furnizues me gjatësi deri në 15m si dhe furnizimi dhe montimi i ndërprerësit në mur.ne çmim te llogariten te gjitha punet, demoluese, suvatuese, te lyerjes dhe te montimit.	copë	4	35	140.00 €
33	Furnizimi, transporti dhe pontimi I lavamanit me dimensione 55x65cm, së bashku me bateri per uje te ngroht dhe te ftofte, furnizimi me gypa per ujesjelles dhe kanalizim, kyqja e tyre ne rrjetet perkatese dhe thyerja e betonit te pllakes dhe mureve, ne çmim te llogaritet edhe furnizimi dhe montimi i pllakave te qeramikes me sipërfaqe 1.5m², si dhe furnizimi dhe montimi i pasqyres me dimensione	copë	1	230	230.00 €
34	Furnizimi, transporti dhe montimi I ne bazament prej betoni nepermjet shputave metalike I dy profileve metalike 10x10cm me lartesi h=250cm, ne çmim te llogaritet edhe trau horizontale me gjatesi L=300cm, dhe me treje terthore 10x10cm, ne çmim te llogaritet edhe ngjyrosja me ngjyre antikoroze dhe ngjyre te yndyrshme ne dy shtesa.	komplet	1	2000	2,000.00 €

35	Furnizimi, transporti, montimi dhe ankerimi I profileve metalike I 18 per mbulimin hyrjes se Ambullantes.Ankerimi I profileve te behet nepermjet pllakave metalike te cila do te montohen ne murin e objektit.ne çmim te llogaritet ngjyrosja me ngjyre antokorozive dhe ngjyre te yndyrshme ne dy shtresa.ne çmim te llogariten edhe trajen terthore prej profileve metalike mbi te cilat do te behet montimi i Qelqit. Siperfaqja per mbulim 5.5m ² .	kg	560	10	5,600.00 €
36	Furnizimi, transporti dhe montimi I xhamit dyshtresor te lameluar me trashesi 2x5mm, montimi te behet me bulona , sipas rregulloreve per keto pozicione.Nuanca e qelqit sipas perzgjedhjes se investitorit.	m ²	7	200	1,400.00 €
Gjithsej meremctimi i AMF-së në Xërxë. :					45,477.50 €

II	PARAMASA PËR LYERJEN DHE RENOVIMIN E QKMF-SË N RAHOVEC				
A	Reparti I Përgjithshëm				
Nr.	Përshkrimi i pozitëonit	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma
1	Prerja dhe demolimi me kujdes I murit ndarës I muratuar me bloka giter për hapjen e derës për ordinancë.Në çmim të llogatritet ngarkimi dhe transporti I materialit në deponi.Llogaria për m ² të murit të thyer.	m ²	3.5	15	52.50 €

2	Furnizimi, transporti dhe muratimi I murit ndarës me blloka Gjysëm giter me llaq prej qimentoje me trashësi të murit b=25cm.Në çmim të llogaritet edhe punimi traht shtaungues prej betoi me prerje tërthore 25x25cm dhe I armuar me armature 4Ø10mm dhe stafa Ø8mm/20cm.	m ²	25	15	375.00 €
3	Furnizimi, transporti dhe suvatimi I nurit me llaq të vazhduar dhe ate në dy shtresa.	m ²	50	7	350.00 €
4	Furnizimi, transporti dhe gjetimi I nurit me glet masë, sipa rregulloreve, në çmim të llogaritet edhe lyerja.	m ²	50	11	550.00 €
5	Furnizimi transporti dhe montimi I derës prej furniri dhe tok prej hekuri, modeli dhe nuanca si ato ekzistuese, me dmimensione 110x200cm, ndërsa toku të jetë me gjerësi 25cm.	copë	1	350	350.00 €
6	Demontimi me kujdes I pllakave të armstrongut së bashku me kondruksion mbajtës, ngarkimi dhe transporti në deponi.	m ²	9	5	45.00 €
7	Furnizimi, transporti montimi I pllakave të armstrongut së bashku me konstrukcion mbajtës, pllakat të jenë idëntike me ato ekzistuese.	m ²	10	35	350.00 €

8	Furnizimi, transporti dhe montimi i llampave ndriçuese LED të pllafonit me kapacitet 40ë, së bashku me kabëll furnizues me gjatësi deri në 15m si dhe furnizimi dhe montimi i ndërprerësit në mur.ne çmim te llogariten te gjitha punet, demoluese, suvatuese, te lyerjes dhe te montimit.	copë	4	35	140.00 €
9	Furnizimi, transporti dhe montimi i vitrinës prej profileve te PVC-së me trashesi t=8.6cm, ne repartin e pergjuihshem, vitrina te jete me kater ndarje vertikale dhe tri ndarje horizontale, dhe tri hapje ne forme shallteri te punuara prej profileve te PVC-se, mbushja e vitrines te jet me 2 xhama.Fiksimi i vitrinës të bëhet në shank dhe në pllafon.	m²	30	100	3,000.00 €
10	Furnizimi, transporti dhe montimi i derës për hyrje te shallteri i korridorit, dera të punohet prej profileve të PVC-se me trashësi t=86mm me mbushje dhe me xham.Dera të jetë me dimensione 90x210cm, së bashku me pjesën e mbiderës me dimesnione 90x110cm.	copë	1	150	150.00 €

11	Furnizimi, transporti dhe pontimi I lavamanit me dimensione 55x65cm, së bashku me bateri për ujë të ngrohtë dhe të ftohtë, furnizimi me gypa për ujësjellës dhe kanalizim, kyqja e tyre në rjetet përkatëse dhe thyerja e betoni në pllakës dhe mureve, në çmim të llogaritet edhe furnizimi dhe montimi i pllakave të qeramikës me sipërfaqe 1.5m ² , si dhe furnizimi dhe montimi i pasqyres me dimensione 60x45cm.	komplet	2	150	300.00 €
12	Furnizimi, transporti dhe lyerja e mureve të dy ordinancave me polikollor dhe ate në dy shtresa.	m ²	130	2	260.00 €
13	Furnizimi, transporti dhe gjetimi i mureve në hapësirat e kshillimores, në çmim të llogaritet edhe largimi i gjetit të demtuar.	m ²	65	11	715.00 €
14	Furnizimi, transporti dhe lyerja e mureve të dy ordinancave me polikollor dhe ate në dy shtresa.	m ²	130	0.2	26.00 €
15	Furnizimi, transporti montimi i pllakave të armstrongut së bashku me konstruktion mbajtës, pllakat të jenë identike me ato ekzistuese.	m ²	10	35	350.00 €

16	Furnizimi, transporti dhe montimi I vitrinës prej profileve të PVC-së me trashësi t=8.6cm, në repartin e Pediatrisë, me pesë ndarje vertikale dhe tri ndarje horizontale, dhe tri hapje në formë shallteri të punuara prej profileve të PVC-se, mbushja e vitrines te jet me 2 xhama. Fiksimi i vitrinës të bëhet në shank dhe në pllafon.	m²	18	100	1,800.00 €
17	Furnizimi, transporti dhe montimi I derës për hyrje të shallteri I korridorit, dera të punohet prej profileve të PVC-se me trashësi t=86mm me mbushje dhe me xham.Dera të jetë me dimensione 90x210cm,së bashku me pjesën e mbiderës me dimensione 90x110cm.	copë	1	150	150.00 €
18	Furnizimi, transporti, riparimi I derës prej profileve të aluminit, shinave dhe brushave, furnizimi dhe ndrimi I sensorit për hapje dhe mbyllje automatike të derës dy krahëshe.	copë	2	80	160.00 €
19	Furnizimi, transporti dhe montimi I vitrinës prej profileve të PVC-së me trashësi t=8.6cm, në repartin e Emergjencës, me pesë ndarje vertikale dhe tri ndarje horizontale, dhe tri hapje në formë shallteri të punuara prej profileve të PVC-se, mbushja e vitrines te jet me 2 xhama.Fiksimi i vitrinës të bëhet në shank dhe në pllafon.	m²	13	100	1,300.00 €

20	Furnizimi, transporti dhe montimi I derës për hyrje te shalteri I korridorit, dera të punohet prej profileve të PVC-se me trashësi t=86mm me mbushje dhe me xham.Dera të jetë me dimensione 90x210cm, së bashku me pjesën e mbiderës me dimesnione 90x110cm.	copë	1	150	150.00 €
21	Furnizimi, transporti dhe pontimi I lavamanit me dimensione 55x65cm, së bashku me bateri për ujë të ngroht dhe të ftofte, furnizimi me gypa per ujësjellës dhe kanalizim, kyqja e tyre në rrjetet përkatëse dhe thyerja e betoni në pllakës dhe mureve, në çmim të llogaritet edhe furnizimi dhe montimi i pllakave të qeramikës me sipërfaqe 1.5m², si dhe furnizimi dhe montimi i pasqyres me dimensione 60x45cm.	komplet	1	200	200.00 €
22	Demontimi me kujdes I kubezave prej betoni ne obor, dhe vendosja e tyre ne vendin e caktuar nga autoriteti kontraktues.	m²	2	20	40.00 €
23	Germimi I dheut te perzier me zhavor me makine per hapjen e themlit per vendosjen e bustit,ne çmim te llogaritet ngarkimi I materialit dhe transporti ne deponi.	m³	1	5	5.00 €
24	Furnizimi, transporti dhe betonimi I themlit te bustit me beton te armuar te klases C30 Mpa, ne Amim te llogaritet edhe armimi I tij.	m³	1.2	150	180.00 €

25	Furnizimi, transporti, latimi, armimi dhe betonimi I bazamentit te bustit me beton te klases C30Mpa. Bazamenti te jeti me dimensione 60x50x150cm, dhe te armohet me armature gjatesore dhe terthore sipas rregulloreve.	m ³	0.5	150	75.00 €
26	Demontimi me kujdes I bustit ne oborrin e QKMF-se, transporti I tij ne pjesen tjeter te oborrit dhe montimi I tij ne bazamentin e ri.	copë	1	100	100.00 €
27	Furnizimi, transporti dhe mveshja e bazamentit te bustit me granit me trashesi t=2cm, me nuance identike me ate	m ²	3.5	180	630.00 €
28	Pastrimi, demolimi I izolimit dhe suvase se vjeter ne bazament dhe muret e fontanes ne oborr.	m ²	20	3	60.00 €
29	furnizimi, transporti, dhe vendosja e bases, suvatimi deri ne finale si dhe punimi I hidroizolimit ne bazen dhe muret e mbrendshme te fontanes.	m ²	20	5	100.00 €
30	Furnizimi, transporti dhe montimi I gureve-rrasave ne fontane, ne çmim te llogaritet edhe largimi I atyre te demtuara.	m ²	8	100	800.00 €
31	Furnizimi, transporti dhe montimi I sisitemit te fontanes, pompimit, furnizimi me uje, si dhe i pjeses elektrike dhe automatike te fontanes.	copë	1	500	500.00 €
32	Furnizimi me dheun humusor, perpunimi, rrafshimi I tij si dhe mbjellja e barit ne pjesen e oborrit ku largohet busti dhe ne pjese tjera ku ka bari te demtuar.	m ²	30	12	360.00 €

33	Demontimi I pjeses se demtuar te mbuleses se kulmit prej llamarine te valezuar, ngarkimi dhe transporti ne dpeoni.	m ²	40	15	600.00 €
34	Demontimi I pjeses se demtuar te mbuleses se kulmit prej llamarine ne murin e atikes, ngarkimi dhe transporti ne dpeoni.	m ²	30	10	300.00 €
35	Furnizimi, transporti dhe montimi I llamarines se valezuar ne kulmin e objekti, llamarina te jete identike ma ate ekzistuese.	m ²	40	15	600.00 €
36	Furnizimi, transporti dhe montimi I llamarines ne atiken e kulmit te objektit, llamarina te jete identike ma ate ekzistuese.	m ²	30	15	450.00 €
37	Pergaditja e dyshemesë për epoksid - gërryerja e keramikes me makinë me disqe diamanti dhe me sfera metalike, mbushja e dilatimeve dhe plasaritjeve me llaq epoksid, riparimet e gropezave eventuale.	m ²	15	10	150.00 €

38	Shtrirja e perimetrit (bazës) epoksid Sikaflor 150 (apo prodhues tjetër me karakteristika të njëjta) në trashësi 1.0mm të cilit duhet të shtohet rërë kuarcime fraksion 0.3-0.8 mm si dhe miell kuarci, mbushja e dyshemesë me rërë kuarci me fraksion 0.3-0.8mm derisa dyshemeja është në gjendje të lenget e cila e ngrit nivelin në min.1.5mm, shtrirja e shtresës së dytë të epoksidit Sikaflor 264 RAL me trashësi 1.0mm, mbushja e dyshemesë me rërë kuarci me fraksion 0.1-0.5mm derisa dyshemeja është në gjendje të lenget, shtrirja e shtresës përfundimtare të epoksidit Sikaflor 264RAL në trashësi 0.5mm, preja (hapja) e fugave dhe mbushja e tyre me shtuko poliuretani Somafix PU.	m ²	15	18	270.00 €
39	Punimi i skajoreve (llajseve) të epoksidit me trashësi 5.0cm në diagonale.	m'	12	5	60.00 €
40	Riparime (mbushje, rrafshime) me epoxy mertell ose Sikascreed Hardtop (pjesa ku paraqitet nevoja).	kg	1	50	50.00 €
II	GJTHSEJ LYERJA DHE RENOVIMI QKMF-SË NË RAHOVEC :				16,103.50 €
III	PARAMASA PËR VENDOSJEN E VITRINES SE QMF NË KRUSHË TË MADHE				
I	PUNËT NDËRTIMORE				

1	Furnizimi, transporti dhe montimi I vitrinës prej profileve të PVC-së me trashësi t=8.6cm, në repartin e Pediatrisë, me pesë ndarje vertikale dhe tri ndarje horizontale, dhe tri hapje në formë shallteri të punuara prej profileve të PVC-se, mbushja e vitrinës të jetë me 2 xhama. Fiksimi i vitrinës të bëhet në shank dhe në pllafon.	m ²	18	100	1,800.00 €
2	Furnizimi, transporti dhe montimi I derës për hyrje të shallteri I korridorit, dera të punohet prej profileve të PVC-se me trashësi t=86mm me mbushje dhe me xham. Dera të jetë me dimensione 90x210cm, së bashku me pjesën e mbiderës me dimensione 90x110cm.	copë	1	150	150.00 €
III	GJITHSEJ LYERJA E ZYRËS SE VENDIT NË KRUSHË TË MADHE :				1,950.00 €

IV	Ndërtimi I depotit të repartit I Hemodializës në Rahovec				
Nr.	Përshkrimi i pozitës	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera
I					
1	Gërmimi i dheut së bashku me kubeza në thellësi deri në 50centimetra, ngarkimi dhe transporti në deponi në largësi deri në 5km.	m ³	10	10	100.00 €
2	Furnizimi, transporti, shtruarja dhe ngjeshja e zhavorit nga guri i thyer me fr.(0-32)mm me trashësi t=20cm.	m ³	4	100	400.00 €
3	Furnizimi, transporti, latimi, përforcimi dhe betonimi me beton jo ujëpërshkues i themelit pllakë me beton të klasës C30/37.	m ³	8	200	1,600.00 €

4	Furnizimi, transporti, latimi, përforcimi dhe betonimi i pllakës së meskatit, shtyllave dhe trajeve me beton të klasës C30/37.	m ³	7	200	1,400.00 €
5	Furnizimi, transporti, prerja, lakimi dhe vendosja në vepër e armaturës R400/500 në themel, mure, shtylla, traje, konstruksion meskatëshe etj.	kg	800	3	2,400.00 €
6	Furnizimi, transporti dhe izolimi i jashtëm i murit me bitulit dhe kondor.	m ²	10	15	150.00 €
7	Furnizimi, transporti dhe muratimi i mureve me blloka giter me llaq të qimentos me gjerësi të murit b=25cm.	m ²	35	15	525.00 €
8	Furnizimi, transporti dhe suvatimi i mureve të mbrendshme dhe të pllafonit me llaq të qimentos dhe ate në dy shtresa.	m ²	60	7	420.00 €
9	Furnizimi, transporti, dhe lyerja e mureve dhe pllafoneve me polikollor dhe ate në dy shtresa.	m ²	60	2	120.00 €
10	Pergaditja e dyshemesë për epoksid - gërryerja e keramikes me makinë me disqe diamanti dhe me sfera metalike, mbushja e dilatimeve dhe plasaritjeve me llaq epoksid, riparimet e gropzave eventuale.	m ²	25	10	250.00 €

11	Shtrirja e perimetrit (bazës) epoksid Sikaflor 150 (apo prodhues tjetër me karakteristika të njëjta) në trashësi 1.0mm të cilit duhet të shtohet rërë kuarcime fraksion 0.3-0.8 mm si dhe miell kuarci, mbushja e dyshemesë me rërë kuarci me fraksion 0.3-0.8mm derisa dyshemeja është në gjendje të lenget e cila e ngrit nivelin në min.1.5mm, shtrirja e shtresës së dytë të epoksidit Sikaflor 264 RAL me trashësi 1.0mm, mbushja e dyshemesë me rërë kuarci me fraksion 0.1-0.5mm derisa dyshemeja është në gjendje të lenget, shtrirja e shtresës përfundimtare të epoksidit Sikaflor 264RAL në trashësi 0.5mm, preja (hapja) e fugave dhe mbushja e tyre me shtuko poliuretani Somafix PU.	m²	25	18	450.00 €
12	Punimi i skajoreve (llajsnëve) të epoksidit me madhësi 5.0cm në diagonale.	m'	20	3	60.00 €
13	Riparime (mbushje, rrafshime) me epoxy mertell ose Sikascreed Hardtop (pjesa ku paraqitet nevoja).	kg	2	50	100.00 €
14	Furnizimi, transporti dhe punimi i iberikut me styropor trashësie t=5cm, në çmim të llogaritët rrafshimi dhe nivelizimi i tij.	m²	25	15	375.00 €
15	Furnizimi, transporti dhe montimi i derës prej PVC-je me trashësi të profilin t=8cm, dera të jetë dykrahëshe me mbushje dhe me xhama, dera të jetë me dimensione:180x240cm.	copë	1	450	450.00 €
16	Furnizimi, transporti dhe punimi i konstrukcionit drunor të pullazit , në çmim llogaritët projektioni horizontal i kulmit.	m²	30	35	1,050.00 €

17	Furnizimi, transporti dhe montimi i Pllakave senduiç me trashësi t=55mm, ne çmim te llogariten edhe shtresa termoizoluese iberçuk , styropor (5+6) si dhe mveshja e pjeseve kendore me llamarine te plastifikuar sipas rregulloreve per realizimin e ketij pozicioni te punes. Llogaria në projektion të pjerët.	m ²	37	85	3,145.00 €
18	Furnizimi, transporti dhe montimi i olluqeve horizontal dhe vertikal prej llamarine me diametër Ø110mm .	m'	10	10	100.00 €
19	Furnizimi, transporti dhe punimi i kablllove furnizuese, montuese, kuti shpërndarëse, trupa ndriçues, ndërprerëse me gjithsej 4 dalje për të gjithë parahyrjen.Në çmim të llogaritet edhe materiali përcjellës dhe shpenzues.	komplet	1	5000	5,000.00 €
20	Furnizimi, transporti, suvatimi izolimi me styropor N4 me trashësi t=10cm dhe fasadimi i jashtëm i objektit me të gjitha punët paraprake dhe përcjellëse.Nuanca përzgjidhet nga ana e organit mbikqyrës.	m ²	32	35	1,120.00 €
IV	GJITHSEJ NDERTIMI I DEPOS TE REAPRTI I HEMODIALIZES NE RAHOVEC				19,215.00 €
V	PARAMASA PËR RRENIMIN E OBJEKTIT MONTAZH TE AMBULLANTA NE RAHOVEC				
I	PUNËT DEMOLUESE				

1	Rrenimi I objektit montazh ish objektit te OSBE-se I cili gjendet prapa objektit te Emergjences. Objekti eshte me etazhitet P+0 dhe rrenimi te beshet se bashku me themelet prej betoni te objektit, ne qmim te llogaritet ngarkimi dhe transporti ne deponi.	m ²	160	82	13,120.00 €
2	Rrenimi I objektit te garazhes se ish objektit te OSBE-se I cili gjendet prapa objektit te Emergjences. Objekti eshte me etazhitet P+0 dhe rrenimi te beshet se bashku me themelet prej betoni te objektit, ne qmim te llogaritet ngarkimi dhe transporti ne deponi.	m ²	32	82	2,624.00 €
3	Largimi dhe bartja e kontejnerave metalik ne vendin e caktuar nga investitori, ne largesi maksimale deri ne 5km, gjate punes te kihet kujdes te behet demtimi I tyre.	m ²	100	10	1,000.00 €
4	Germimi I dheut ne thellesi deri 30cm , ngarkimi I tij dhe rrafshimi I terrenit te germuar.	m ²	910	3	2,730.00 €
5	Furnizimi, transporti, shtruarja, rrafshimi dhe ngjeshja e zhavorit me fraksion fr.(0-63)mm, me trashesi t=25cm.	m ³	240	15	3,600.00 €
V	GJITHSEJ PUNET E RRENIMIT DHE TE SHTRUARJES ME ZHAVOR :				23,074.00 €

MEREMETIMI I ZYREVE TË VENDIT NE KOMUNEN E RAHOVECIT

REKAPITULIMI I PERGJITHSHEM

I	Renovimi I AMF-se në Xërxë	45,477.50 €
II	Renovimi I QKMF- se ne Rahovec	16,103.50 €

III	QMF në Krushë të Madhe	1,950.00 €
IV	Depo te Dializa ne Rahovec	19,215.00 €
V	Rrenimi I objektit montazh te ambullanta ne Rahovec	23,074.00 €
TOTALI :		105,820.00 €

